REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

# VENDIM

**Nr.__12__ Datë.10/07/2025**

***PËR TRANSFERIMIN NË BASHKITË PËRKATËSE, TË PAJISJEVE QË DO TË BLIHEN NË KUADËR TË PROJEKTEVE TIP "RIVITALIZIMI I PRESPËS TË VOGËL" DHE "BLERJE PAJISJE PËR INFOPOINT B.MALIQ, PROJEKTI GORA E TRADITËS"***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",i ndryshuar, në kërkesat e Bashkisë Devoll dhe Bashkisë Maliq, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.40 dt.21.10.2024 "Mbi miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit midis GIZ dhe Këshillit të Qarkut Korcë", Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.51 dt.23.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, si dhe urdhërin nr.61 dt.19.06.2025 "Për detajimin e projekteve të investimeve TIP", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

# VENDOSI

1. Të miratojë transferimin te Bashkia Devoll, të pajisjeve si më poshtë, që do të blihen në kuadër të projektit TIP "Rivitalizimi i Prespës të Vogël". Transferimi do të kryhet me cmimet e prokuruara të pajisjeve.
   - Kayak gome 1 (një)copë
   - Kayak Plastik për 2+1 persona 2 (dy )copë
   - Stand up paddle 1 (një) copë
   - Bicikleta mountainbike 3 (tre )copë

2. Të miratojë transferimin te Bashkia Maliq, të pajisjeve si më poshtë, që do të blihen në kuadër të projektit TIP "Blerje pajisje për Infopoint B.Maliq, projekti Gora e Traditës". Transferimi do të kryhet me cmimet e prokuruara të pajisjeve.
   - Ekran Led 55 1 (një) copë
   - Desktop 1 (një) copë
   - Fotokopje multifunksionale 1 (një) copë
   - Kondicioner 1 (një) copë
   - Tabelë Infopoint 1 (një) copë
   - Tavolinë pune në formë L dhe komodinë 1 (një) copë
   - Karrige rrotulluese zyre 1 (një) copë
   - Karrige të thjeshta zyre 5 ( pesë) copë

3. Transferimi do të kryhet në momentin e përfundimit të procedurave të blerjes të pajisjeve nga ana e Këshillit të Qarkut dhe dorëzimi i tyre te bashkitë përkatëse do të bëhet bazuar në dokumentacionin mbështetës.

4. Pajisjet sëbashku me specifikimet përkatëse janë sipas kërkesave të ardhura nga Bashkitë Devoll dhe Maliq, bashkëngjitur këtij vendimi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet gjithë administrata e Këshillit të Qarkut Korcë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

**KRYETARI**
**Erjon Nexhipi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Mimoza Shuli**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KESHILLI I QARKUT KORCE

| | |
|---|---|
| **Miratuar me** | **16 / Vota** |
| **Vota Pro** | **16 / Vota** |
| **Vota Kundër** | **0 / Vota** |
| **Vota Abstenim** | **0 / Vota** |
| **Zbardhur më datë** | **10/07/2025** |

**Konceptoi O. Beqiraj**
**Juristi M.Bylykbashi**
**Sek. K. Qarkut B. Muço**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Nr. 41 Prot                                                                 Korcë, më 30/06/ 2025

# RELACION

## *PËR TRANSFERIMIN NË BASHKITË PËRKATËSE, TË PAJISJEVE QË DO TË BLIHEN NË KUADËR TË PROJEKTEVE TIP "RIVITALIZIMI I PRESPËS TË VOGËL" DHE "BLERJE PAJISJE PËR INFOPOINT B.MALIQ, PROJEKTI GORA E TRADITËS"*

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.10296 DT.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar, udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",i ndryshuar, në kërkesat e Bashkisë Devoll dhe Bashkisë Maliq, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.40 dt.21.10.2024 "Mbi miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit midis GIZ dhe Këshillit të Qarkut Korcë", Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.51 dt.23.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, si dhe urdhërin nr.61 dt.19.06.2025 "Për detajimin e projekteve të investimeve TIP", propozojmë për miratim transferimin në Bashkinë Devoll dhe në Bashkinë Maliq, të pajisjeve që do të blihen në kuadër të 2 projekteve TIP të përzgjedhura fituese nga GIZ.

Këshilli i Qarkut Korcë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me GIZ-in në lidhje me bashkëpunimin e palëve në zhvillimin e produkteve turistike, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit nr.40 dt.21.10.2024. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Qarkut do të financojë 2 nga projektet TIP fituese të përzgjedhura nga GIZ. Dy projektet TIP të përzgjedhura për tu financuar nga Këshilli i Qarkut janë:

1- "Rivitalizimi i Prespës të Vogël", Bashkia Devoll
2- "Blerje pajisje për Infopoint B.Maliq, projekti Gora e Traditës".

Të dyja bashkitë dërguan kërkesat pranë Këshillit të Qarkut, me specifikimet dhe detajimet e nevojshme në lidhje me vënien në zbatim të projekteve fituese. Të dyja këto projekte konsistojnë në blerjen e pajisjeve që do i shërbejnë realizimit të tyre.
Procedurat e prokurimit të blerjeve do të realizohen nga Këshilli i Qarkut në periudhën në vazhdim sipas specifikimeve dhe kërkesave të Bashkive dhe në momentin e përfundimit të procedurave të blerjes të këtyre pajisjeve, Këshilli i Qarkut do të vijojë me transferimin dhe dorëzimin e tyre përkatësisht në Bashkinë Maliq dhe Bashkinë Devoll. Ky tranferim do të shoqërohet nga dokumentacioni mbështetës sipas udhëzimeve përkatëse.

Konkretisht pajisjet që do të prokurohen dhe do tju transferohen bashkive janë:

1. Bashkia Devoll. Pajisjet që do të blihen në kuadër të projektit TIP "Rivitalizimi i Prespës të Vogël". Transferimi do të kryhet me cmimet e prokuruara të pajisjeve.

| | |
|---|---|
| - Kayak gome | 1 (një)copë |
| - Kayak Plastik për 2+1 persona | 2 (dy )copë |
| - Stand up paddle | 1 (një) copë |
| - Bicikleta mountainbike | 3 (tre )copë |

2. Bashkia Maliq. Pajisjet që do të blihen në kuadër të projektit TIP "Blerje pajisje për Infopoint B.Maliq, projekti Gora e Traditës". Transferimi do të kryhet me cmimet e prokuruara të pajisjeve.

- Ekran Led 55 1 (një) copë
- Desktop 1 (një) copë
- Fotokopje multifunksionale 1 (një) copë
- Kondicioner 1 (një) copë
- Tabelë Infopoint 1 (një) copë
- Tavolinë pune në formë L dhe komodinë 1 (një) copë
- Karrige rrotulluese zyre 1 (një) copë
- Karrige të thjeshta zyre 5(pesë) copë

Bazuar në sa më sipër cituar, i propozojmë Këshillit të Qarkut të miratojë P/Vendimin ***"Për transferimin në bashkitë përkatëse, të pajisjeve që do të blihen në kuadër të projekteve tip "rivitalizimi i prespës të vogël" dhe "blerje pajisje për infopoint b.maliq, projekti gora e traditës"***

P.Finance
Oljona Beqiraj